



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Korrik 2021

Nr: 428

VENDIM

PËR

**PËRCAKTIMIN E VLERËS NË PARA TË NJË VOTE TË VLEFSHME PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”,

VËREJ:

Neni 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton me vendim vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

Referuar lidhjes nr. 1, të vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”, partitë që kanë përfituar jo më pak se 1 përqind të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë:

1. Partia Socialdemokrate (PSD)	35,475 vota	2,2479%
2. Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	107.538 vota	6,8143%
3. Partia Demokratike “Aleanca për ndryshim” (PD-AN)	622.187 vota	39,4259%
4. Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	768.134 vota	48,6741%
Gjithsej vota të vlefshme	1 533 334 vota	



Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, referuar pikës 4, të nenit 180 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit, parashikohet të ishte 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Fondi i vënë në dispozicion në vitin zgjedhor 2017 ishte 65,000,000 lekë, pra rrjedhimisht u caktua që për vitin zgjedhor 2021 fondi i përgjithshëm i miratuar të ishte 130,000,000 lekë.

Referuar nenit 88, pika 2, të Kodit Zgjedhor, pjesëtimi i fondit të përgjithshëm të miratuar me numrin në total të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje që kanë marrë jo më pak se 1 përqind të votave të vlefshme në shkallë vendi sjell si rezultat vlerën në para të 1 (një) vote të vlefshme 130,000,000 (njëqind e tridhjetë milion) lekë / 1,533,334 (një milion e pesëqind e tridhjetë e tre e treqind e tridhjetë e katër) vota = 84,78 (≈ 85) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”

V E N D O S:

1. Vlera në para e një vote të vlefshme është 85 (tetëdhjetë e pesë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

